



Drejtoria për Arsim

Nr. 111-27344/2025

Datë 20.08/2025

Në bazë të nenit 28, paragrafi 2 të Ligjit nr. 04/L-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional dhe në bazë të nenit 12 paragrafi 1 të Ligjit nr. 04/L-143 për Arsimin dhe Aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovës si dhe në kërkesën e IAAP "Fehmi Agani" në Klinë nr. 04-111-27344/25 e datës 20.08.2025, Drejtoria e Arsimit më datën 20.08.2025, shpall këtë:

KONKURS

Për regjistrimin e vijuesve të rritur në arsimin e mesëm të lartë të arsimit profesional-klasa X

Nr.	Shkolla	Nr.i paraleleve	Nr.i nxënësve	Lëmia dhe profili	Gjithsej
1	IAAP "Fehmi Agani"	1	11	Informatikë	11
		1	11	Instalues Elektrik	11
		1	11	Automekanik	11
		1	11	Instalues i Ujit dhe Kanalizimit	11
		1	11	Trafik Rrugor	11
		1	11	Operator Prodhimi	11
		1	11	Gjeologji	11
		1	11	Xehetari	11
		1	11	Laborant i Biologjisë	11
		1	11	Kontabilitet dhe Tatime	11
		1	11	Agrobiznes	11
		1	11	Ndërtimtari	11
		1	11	Konfeksioner	11
		1	11	Teknologji ushqimore	11
	Gjithsej	14	154		154

-REGJISTRIMI I VIJUESVE NË PROGRAMIN "Arsimi për të rritur", bëhet sipas procedurave të njëjta të regjistrimit për nxënësit e rregullt, siç është paraparë në Ligjin nr. 04/L-143 për Arsimin dhe Aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovës dhe Udhëzimeve Administrative të MASHT-it.

Në programin "Arsimi për të rritur" në shkollat e mesme të larta, vijuesve ju mundësohet që një vit të plotë shkollor ta përfundojnë në afat prej 18 javë mësimi (UA nr. 40/2006 MASHT).

Të drejtë regjistrimi kanë të gjithë të interesuarit, të cilët kanë kaluar moshën për të qenë nxënës të rregullt.

Dokumentet e nevojshme për regjistrim:

1. Deftesat e klasave të kryera paraprake.

2. Ekstrakti i lindjes.

3. Pagesa.

Shkollimi në nivelin e arsimit të mesëm të lartë është me pagesë. Participimi bëhet në bazë të Rregullores nr. 01/2017, dt. 02.02.2017 për planifikimin dhe shpenzimin e të hyrave vetanake të realizuara nga institucionet e arsimit dhe aftësimi profesional dhe arsimit për të rritur, rregullore për taksat, ngarkesat dhe gjobat komunale nr. 0-434-1677/2019 e datës 25.04.2019.

Pagesa e regjistrimit për vijuesit e arsimit për të rritur:

- Për regjistrim të vitit (për një klasë).....100 €;
- Për praktikë profesionale.....50 €;
- Provim diferencial.....10 €;
- Provimi përfundim, certifikatën-diplomën.....50 €;

Pagesat bëhen në institucionet përkatëse edukativo-arsimore sipas kodeve të shkollave:

Vijuesit, të cilët ndërrojnë profilin, do t'u nënshtrohen provimeve diferenciale, bazuar në UA 16/20211, dt. 30.12.2011 të MASHT-it.

Kandidatët, të cilët ndërrojnë drejtimin, janë të obliguar që paraprakisht t'u nënshtrohen provimeve plotësuese dhe diferenciale.

~~Dhënia e provimeve plotësuese dhe diferenciale bëhet në afat të veçantë nga vijimi i klasës, për të cilën kandidati është paraqitur për regjistrim~~

Dëftesat dhe diplomat që merren në programin "Arsimi dhe aftësimi për të rritur" janë të barasvlershme me diplomat e arsimit formal.

Konkursi është i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit në webfaqe të komunës dhe në tabelën e shpalljeve në IAAP "Fehmi Agani" në Klinë.

Drejtori DKA-së

Dr.sc. Qemajl Sejdiu

